

Ditët e aksionit nga 6 – 9 shkurt

«Zvicra jemi të gjithë ne!»

2

Kërkohet barazi pagash tani

Jo gjëra të lëna përgjysmë

3

Në Lozanë të Kantonit Vaud (Waadt)

U themelua grupi i sindikalistve shqiptar

4

Nr. 2 | prill 2016 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

Zbatimi i iniciativës mbi migrimin masiv

Në vend të kuotave: Mbrojtje e pagave dhe kushteve të punës



Pamje nga aksioni i përbashkët në sheshin përballë stacionit kryesor të trenit në Bernë

Më 9 shkurt 2014 u aprovua nga elektorati zviceran e ashtuquajtura iniciativa mbi migrimin masiv (MEI), gjë që qoi në shtimin e një Neni (121a) në Kushtetutën zvicerane. Më 24 mars 2016 qeveria federale ka prezantuar propozimin për zbatimin e saj. Ky propozim parasheh ndër të tjera fuqjen e kontingjenteve, gjë që sindikata Unia e kundërshton ashpër. Kuotat qojnë në diskriminim në tregun e punës dhe vejnë në pyetje radikale qarkullimin e lirë të personave. Në të njëjtën kohë Unia kërkon që të fuqizohet mbrojtja e pagave dhe kushteve të punës.

Iniciativa mbi migrimin masiv kishte për qëllim, të reduktojë migrimet në Zvicër. Zbatimi i saj venë Zvicërën para sfidave të mëdha, pasi kjo iniciativë është në kundërshtim me lirinë e lëvizjes të personave. Lëvizja e lirë e personave ka siguruar të drejta siguri leje qëndrimi për shumë punëmarrës dhe paraqet parakusht për marrëveshjet bilaterale me BE-në. Qeveria federale është duke provuar të negociojë një zgjidhje me BE-në, për të zbatuar iniciativën e për të mos rrezikuar Marrëveshjet bilaterale. Deri më tani pa sukses...

Propozime për zbatimin e Nenit të ri kushtetues

Qeveria federale prezantoi disa projektligje për zbatimin e nenit të ri kushtetues. Kështu ajo propozoi që migrimin ta orientoj përmes një klauzole mbrojtëse. Për çdo vit do të përcaktohet një prag i numrit të

migrimeve. Nëse ky prag tejkalohet, atëherë qeveria duhet të përcaktojë numrat maksimal, pra kontingjentet. Nga ky prag dhe kontingjente përfshihen lejet e shkurtra të qëndrimi deri në 4 muaj.

Qeveria federale pos tjerash donë që së pari ta shterë potencialin e fuqisë punëtore vendëse dhe atë të personave azilkërkuar, të cilët guxojnë të qëndrojnë në Zvicër, t'u ua lehtësoi qasjen në punë. Njëherazi ajo ka vendosur ndryshimin e ligjit për të huaj, i cili parasheh që personat punëkërkuar që vijnë nga jashtë të mos kenë të drejtë të marrin ndihmë sociale. Më tej qeveria federale ka aprovuar edhe mesazhin për zgjerimin e marrëveshjes për lëvizjen lirë në raport me Kroacinë. Ratifikimi e protokollit me Kroacinë është parakusht për pjesëmarrje të Zvicrës në programin hulmues Horizon 2020.

Kuotat qojnë në diskriminim

Për Unia-n nuk është i pranueshëm propozimi i qeverisë federale. Kuotat qojnë në diskriminim. Zgjidhja e prezantuar qon në rritjen e lejeve të shkurtra të qëndrimit dhe përkeqësim të marrëdhënieve. Përvoja tregon se kuotat rrisin varësinë e punëmarrësve nga punëdhënësit. Ata nuk do të mund të mbrohen kundër shkeljeve ligjore dhe ato që janë në kundërshtim me Kontratave Kolektive të Punës. Kjo krijon mundësinë për shtypje pagash. Këtë e tregon edhe statusi i ish punëtorëve stinorë.

Të fuqizohen detyrimisht masat mbrojtëse gjithëpërfshirëse

Për të garantuar pagat, kushtet e punës dhe vendet e punës, nuk nevojiten kuotat, porse masa më të mira gjithëpërfshirëse mbrojtëse (FlaM). Andaj për sindikatën Unia është e papranueshme heqja dore nga ana e qeverisë federale për të zgjeruar masat gjithëpërfshirëse mbrojtëse dhe kështu të mos mbrojtë punëmarrësit.

Sindikatat i kanë bërë propozime të ndryshme qeverisë federale, se si do të mund të përmirësoheshin pasat mbrojtëse gjithëpërfshirëse:

■ Fuqizimi i Kontratave Kolektive të Punës (KKP): Duhet të lehtëso-

het detyrimi i vlefshmërisë së përgjithshme. Vetëm nëse për një sektor të caktuar ekonomie vlejën për të gjithë pagat detyruese minimale, mund edhe të garantohet respektimi i tyre i suksesshëm.

■ Më shumë kontrole dhe sanksione të qëndrueshme: Federata duhet të lejë në dispozicion më shumë mjete, për të zgjeruar kontrollet e nevojshme.

■ Mbrojtje më e mirë e shkarkimit nga puna, posaçërisht për punëmarrës të moshuar.

Neni 121a i Kushtetutës federale të fshihet

Një zgjidhje për situatën e komplikuar me BE-në ofroj iniciativa «Dalje nge qorrsoaku! Heqja dorë nga rifutja e kuotave të migracionit» (RASA). Kjo propozon që neni 121a e Kushtetutës federale të fshihet përgjithmonë nga Kushtetuta vendit. Edhe rrethet e djathta janë duke menduar për të shtuar për votim para popullit propozime ndryshuese të nenit 121a, për të mos vu edhe më tej në pikëpyetje marrëdhëniet me BE-në. Është urgjente trajtimi i këtij propozimi. Mirëpo edhe masa më të mira gjithëpërfshirëse mbrojtëse për të garantuar më shumë mbrojtje për punëmarrësit.

Marilia Mendes

Editorial



Të dashur/a lexues/e

Te tendosur qëndrojmë me sytë ngulur televizorëve, laptopëve e smartfonëve, shkruajmë panda SMS e mesazhe edhe përmes Watsaap-it, deri në kohën kur vjen shtendosja – «Iniciativa mbi zbatim dëbimin» është refuzuar! Shumë veta më pyesin se a kam festuar më pas. Jo, në të vërtetë nuk kam festuar. Edhe pse jam ndier e lehtësuar, më është dashur të vi në përfundim: me siguri se ishte një po për shtetin e së drejtës dhe për demokraci, mirëpo jo gjithsesi një po për migrantët. Jo, arsye për të festuar kemi shumë pak, pasi të drejtat e migrantëve edhe më tej janë duke u shkelur dhe kështu edhe të drejtat e të gjithë neve. Në konferencën për shtyp menjëherë pas votimeve, Sindikatat e Bashkuara të Zvicrës njoztuan për «ofensivën mbi marrjen e shtetësisë». Një iniciativë kjo, e cila synon të njëjtin qëllim, e i cili u kristalizua gjatë ditëve të aksionit: migracioni është një realitet, jo veçanti, por fakt; Migrantët jetojnë në Zvicër dhe kështu ata janë pjesë e këtij vendi. Ose thënë ndryshe: ne të gjithë jemi Zvicra.

Ne nuk jemi mysafirë, por jetojmë këtu dhe sikur të gjithë të tjerët kemi obligime, por kemi sikur të gjithë të tjerët kemi edhe të drejta. Ne tani këto të drejta duhet ti kërkojmë! Kjo domethënë se, ne duhet të heqim dorë nga fshehja. Pa marrë parasysh se a jemi përkohësisht apo do të qëndrojmë edhe për pjesën tjetër të mbetur të jetës sonë në Zvicër. Kush jeton këtu bashkë-ndërton këtë vend dhe shoqërinë. Në përputhje më këtë fakt, të gjithë duhet të kenë të drejta të njëjta: të ketë një strehim të mirë, punë të paguar me korrektësi, të drejtë të njëjtë penale dhe pjesëmarrje politike, janë disa nga to. Ne jemi shumë larg këtyre, mirëpo ndryshimi fillon në vetë kokat tona. Të angazhohemi të gjithë bashkë për të drejtat të të gjithë migrantëve dhe të pranojmë se jemi pjesë e këtij vendi. Zvicra jemi ne të gjithë!

Aurora Garcia

Drejtuuese e migracionit në Unia

News

Ripërtëritja e KKP kombëtare për Gastronomi

Partnerët social të gastronomisë janë pajtuar për Kontratën Kolektive Kombëtare të Punës (KKP-K) të Gastronomisë. Ajo do të jetë e plotfuqishme dhe e detyrueshme nga 1 janari 2017. Unia bashkë me organizatat tjera të punëmarrësve Syna dhe Union Hotel&Gastro si organizatat e punëdhënësve Swiss Catering Association, GastroSuisse dhe hotelleriesuisse ka negociuar Kontratën e re në fjalë. Deri në qershor të gjithë partnerët social duhet të aprovojnë Kontratën e re. Pastaj do të njoftohen të gjithë personat dhe ndërmarrjet për të cilët vlen Kontrata e re do të njoftohen në mënyrë gjithëpërfshirëse mbi rrisitë e kësaj Kontrate dhe në vijim do të shtrohet kërkesa në qeverinë federale për shpallje të vlefshmërisë detyruese të Kontratës së re.

Rezoluta «badanti»



Kujdestaret e të moshuarve («badanti») janë të indinjuar me keqadmirimin në sektorin e tyre të punës. Andaj, përmes një rezolute ato kërkojnë përmirësimin e gjendjes së tanishme. Rezoluta e aprovua me rastin e takimit të parë në nivel Kantonit të shërbimit «badanti», i cili u mbajt më 6 mars 2016 në Paradiso (Kantoni TI). Në këtë rezolutë dorëzuar këshilltarit shtetëror nga Tiçiono Unia kërkon të bëhet e vlefshme Kontrata Kolektive e Punës (KKP) edhe për të ashtuquajturën «badanti» (përkujdesjen për të moshuarit në amvisnit private). Pos tjerash duhet të sigurohen më shumë mjete financiare për kujdestarinë shtëpiake të personave të moshuar.

Shkarkime masive tek Sulzer-i

Koncerni industrial Sulzer donë të mbyll selinë e saj në Winterthur dhe kështu të hudhë në rrugë 90 veta. Si shkas ndërmarrja përmend frangun e fuqishëm. Mirëpo shkaku i vërtetë është edhe rritja maksimale e fitimit. Pasi tanimë Sulzer ka paralajmëruar shpërndarje e fitimit (dividentës) së veçanta për aksionarët. Dhe shefi i ri ekzekutiv (CEO) i Sulzer merr për veti një premi fillestare prej gati 3 miliona frangave. Për këtë arsye tanimë 90 veta duhet të paguajnë me humbjen e vendit të tyre të punës. Unia kërkon nga Sulzer që të ruaj vendet e punës në Winterthur. Mirëpo edhe politika duhet të veprojë. Unia kërkon urgjentisht ndërmarrje të masave politike në mbrojtje të të punësuarve dhe për një politik të vendosur industriale.

Votimet federale të 28 shkurtit 2016

Po vlerave demokratike!

Ne ia dolëm: Votuesit zviceran i tha «JO» të ashtuquajturës „Iniciativë për zbatim të dëbimit“! Ky rezultat u arrit falë mobilizimit masiv të shoqërisë civile. Përkundër këtij gëzimi: Në vjeshtë hynë në fuqi zbatim i iniciativës së dëbimit. Kjo domethënë, të huajt do të dënohen më rreptë se sa zviceranët.

Krahas «Iniciativës për zbatimin e dëbimit» u votuan edhe projektligje tjera. Kështu u refuzua me 59,9% edhe «Iniciativa për ndalimin e spekulimit me artikuj ushqimor» si dhe me 50,8% iniciativa e Partisë Popullore e Krishterë (CVP-së). Në të kundërtën u aprovua iniciativa për tunelin e dytë në Gotthard me 57%. Mjersht u refuzuan edhe dy iniciativa sindikaliste, ajo për ndalimin e dumpingut në paga në Cyrih si dhe referendum kundër ligjit për orarin e shitoreve në Tiçino, i cili parashihte zgjatjen e orarit të punës të shitoreve.

Jo njerëzore dhe kundër shtetit të së drejtës

«Iniciativa për zbatimin e dëbimit» kishte për qëllim sipas deklaratave të SVP-së (Partisë Popullore të Zvicrës) zbatimin e iniciativës së dëbimit, e cila parashihte dëbimin automatik të



Manifestimi i gupit të magricionit të regjionit Cyrih-Shafnauzen

«kriminelë». «Iniciativa për zbatimin e dëbimit» shkonte shumë më larg se sa Iniciativa për dëbim dhe kishte për qëllim të eliminonte parimin e barazisë para ligjit dhe dëbimin e njerëzve për shkelje të vogla kundërvajtës. Ajo paraqiste edhe një sulm të drejtpërdrejtë të punës së sindikatave, tek të cilat kemi shumë punëmarrës pa pasaportë zvicerane janë anëtarë.

Bashkë ia kemi arritur

Kështu Unia është angazhuar aktivisht me një fushatë të gjerë kundër iniciativës. Pikërisht «Apeli urgjent», i cili u iniciua nga sindikatat, ka shkaktuar një dinamikë enorme. U grumbulluan mbi një milion fran-

ga për pllakatet dhe insertet. Edhe shumë nisma tjera mundësuan mobilizimin e shoqërisë civile. Rezultati tregoi se me forca të bashkuara mund t'ia arrijmë ta ndalim hovin popullzimit të djathtë. «iniciativa për zbatim të dëbimit» u refuzua me 58,9% të votave.

Përkundër gëzimit ...

Në të vërtetë nuk duhet të harrojmë që Parlamenti me rastin e implementimit të iniciativës së dëbimit po krijon një drejtësi të veçantë për njerëzit pa pasaportë zvicerane. Pasi, pas 1 tetorit 2016 të huajt do të dëbohen automatikisht, në rast se dënohen plotfuqishëm për vepra të caktuara

(të rënda) penale. Megjithatë, në katalogun e ri të delikteve është edhe keqpërdorimi social i emërtuar si vepër penale. Kjo d.m.th. në rast se heshtën në sigurimet shoqërore shumat nga 300 franga, atëherë personi në fjalë mund të dëbohet. Vetëm klauzola për raste të rënda do të mund të pengonte dëbimin. Ajo parashihet, që në raste të rënda të rethanave personale, mund të hiqet dorë nga dëbimi. Me këtë rast do të merren parasysh të huajt e lindur e rritur në Zvicër.

Shfrytëzoje të drejtën Tëndë tani!

Sindikatat pas votimeve të 28 shkurtit kanë paralajmëruar nisjen e një ofensive për aplikim të marrjes së shtetësisë. Më këtë nismë synohet që të huajt që plotësojnë kriteret e marrjes së shtetësisë, të motivohen të shfrytëzojnë këtë të drejtë. Në anën tjetër do të shihet që komunat dhe kantonet të jenë më aktive de tu drejtohen kandidatëve për marrje të shtetësisë, për tu krijuar ndjenjën se «ne të duam Ty». Përqindja e të huajve në Zvicër, për shkak të politikës së ashpër të dhënies së shtetësisë, mbahet artificialisht e lartë. Është koha, që kjo politikë të ndryshohet dhe që Zvicra ti pranojë «zviceranët pa pasaportë» dhe ti njeh ata!

Aurora García

Ditët e aksionit të 9 shkurtit

«Zvicra jemi të gjithë ne»



Pamje nga manifestimi në Bazel në kuadër të ditëve të aksionit nga 6-9 shkurt

Edhe dy vjet pas aprovimit të ashtuquajturës «Iniciativë mbi migrimin masiv», respektivisht përkritazi me Nenit 121a të Kushtetutës federale, ne kërkojmë një Zvicër të hapur dhe solidarë. Për të bërë të dukshme këtë dhe kërkesat tjera, nga 6-9 shkurt u zhvilluan aktivitete të ndryshme në tërë Zvicrën.

Edhe aktivitetet e sivjetme u zhvilluan nga grupimi «Zvicra jemi të gjithë ne», i cili grupim u krijua pas aprovimit të «Iniciativës mbi migrimin masiv» të 9 shkurtit 2014. Një vit më pas, më 7.2.2015 në Bernë u organizua një Kongres i migrantëve dhe njerëzve me sfond migracioni. Bashkë iniciator i këtij Kongresi ishte edhe sindikata Unia.

Të hapur dhe solidar: Pjesëmarrje për të gjithë!

Nga 6 deri më 9 shkurt 2016 janë zhvilluar aksione të decentralizuara në të gjithë Zvicrën – festa, tryeza diskutimi, grupe pune, apo tryeza informative. Cilido aktivitet, i përgjedhur, ka kërkuar po të njëjtën gjë: një Zvicër të hapur dhe solidarë pa përjashtime dhe diskriminim. Mi-

gracioni dhe shumëllojshmëria është një realitet shoqëror. Aktualiteti zviceran do të duhej të bashkë-vendosej dhe të formësohej në mënyrë të barabartë nga të gjithë njerëzit që jetojnë këtu – pa përjashtim dhe pavarësisht nga origjina, besimi, kombësia, gjinia, orientimi seksual, prejardhja e prindërve apo gjyshërve, etj. Do të duhej të krijohet një politikë e re inkluzive (përfshirëse) për të gjithë që janë këtu dhe për ata që do të vijnë.

Shumë aktivitete

Përderisa në shumë vendbanime të vogla, në të cilat Unia dhe Organizata tjera të ndryshme përmes tavolina informative dhe shpërndarjen e fletëpalosjeve zhvillonin fushatë kundër «Iniciativës mbi zbatimin e

dëbimit», nëpër qytetet e mëdha u organizuan manifestime të mëdha. Në Bazel dhe Neuenburg fundjava filloi me festa dhe aktivitete kulturore, si vallëzim apo tregim historish dhe përfunduan me demonstrata, gëgjësisht me grupe pune, ndërsa e shtuna në Gjenevë ofronte të gjitha bashkë: së pari festa, pastaj një tryezë e gjërë diskutimi mbi temën e integritimit.



Pamje nga manifestimi i ditëve të aksionit në Gjenevë

Aurora García

Bojaxhi-Suvatues

Pensionim i mëhershëm edhe për bojaxhinjtë dhe suvatuesit!

Bojaxhinjtë dhe suvatuesit përditë kryejnë një punë të mundimshme. Vetëm pak nga ta ia arrijnë të punojnë deri në moshën e pensionimit të rregullt. Për këtë arsye ka kohë që Unia kërkon mundësitë e pensionimit të mëhershëm. Në fillim të vitit 2016 në bisedimet e partnerëve social është arritur një pajtim për një model. Një sukses i rëndësishëm, i cili ka ndikim sinjalizues edhe për sektorët tjerë.



Profesioni i bojaxhinjëve dhe suvatuesve nuk është i lehtë

Qe 11 vite sindikata Unia për bojaxhinjtë dhe suvatuesit e Zvicrës gjermane, ata të Jura-s si dhe për bojaxhinjtë e Tiçinos, kërkon mundësinë e pensionimit të mëhershëm. Tani është arritur një depërtim: delegacioni i bisedimeve i Shoqatës së bojaxhinjëve dhe suvatuesve të Zvicrës (SMGV) dhe sindikatat Unia e Syna janë pajtuar për një model të parapensionimit. Kontrata e re Kolektive e Punës (KKP) duhet të ratifikohet nga organet e Organizatave pjesëmarrëse.

Pensionim fleksibël nga moshë 60 vjeç

Modeli parasheh mundësinë e pensionimit të pjesshëm fleksibël nga moshë 60 vjeç për burra dhe nga ajo 59 vjeç për gra, si dhe pensionimi tërësisht i parakohshëm me moshën

63, gjegjësisht me 62 vjeç. Deri në pensionimin e rregullt të prekurit marrin një pension kalimtar prej 70% të pagës së AHV/AVS. Gjithashtu paguhen edhe kontributet për shtyllën e dytë. Modeli do të financohet me përqindje të barabartë nga punëmarrësit dhe punëdhënësit me nga 0,85% të shumës së pagës. Llogaritjet që profesionistët e parë do të përfitojnë nga janari vitit 2018 nga ky model.

Rritje pagash para së gjithash për punëtorët e rinj KKP e re pos tjerash parasheh rritje pagash për vitin 2016 dhe 2017

për të gjithë nga 25 franga në muaj. Njëkohësisht do të rriten edhe pagat minimale për punëmarrësit në vitin e parë, të dytë dhe të tretë të përfundimit të aftësisë profesionale në vitin shkollor 2016 dhe 2017, në shumë prej 30 frangave, ndërsa ato të kryepunëtorit dhe punëtorëve të kualifikuar në shumë prej 12.50 franga. Pensionimi i mëhershëm në sektorin e bojaxhinjëve-suvatuesve është një hap i rëndësishëm përpara, për të futur gjithashtu një model të pensionimit të mëhershëm edhe për sektorët dhe profesionet që kryejnë punë të rënda trupore.

➔ Aurora García

1 Maji, dita e punëtorëve

«Të luftojmë bashkërisht – për pensione më të mira të AHV/AVS»

Një maji i sivjetshëm mbahet nën shenjë të Iniciativës së AHV/AVSplus të sindikatave. Mirëpo edhe në shenjë të idesë tradicionale të sindikatave: Fuqia jonë mbështetet në kolektivën, në luftën e përbashkët! Pikërisht në kohërat, kur të arriturat dhe kërkesat sindikaliste janë të atakuar fuqishëm.



Motoja e 1 Majit 2016: Bashkë për pensione më të mira!

Në shtator do të votohet për Iniciativën AHV/AVSplus. Pas dy dekadave pa përmirësime substanciale tek shtylla e parë e sigurimeve shoqërore AHV/AVS është koha, që me këtë votim të shënohet një cikël i përmirësimeve të pensioneve tek AHV/AVS. Duke pasur parasysh fushatën frikësuese 20 vjeçare të së djathtës borgjeze dhe të ekonomisë financiare kundër AHV/AVS, ky votim paraqet një sfidë të madhe. Andaj 1 Maji i sivjetmë këtë çështje do ta ketë në qendër të vëmendjes.

Bashkë jemi më të fortë!

Mirëpo ne nuk harrojmë, se ne do të përballemi me sulme të ashpra. Atakim të të drejtave të migranteve si dhe siguria e leje qëndrimit të tyre në Zvicër sa vjen e vihet më shumë në pikëpyetje; apo në sektorin e Kontratave Kolektive të Punës, disa punëmarrës pretendojnë se ato nuk nevojiten. Andaj ne duhet në përgjithësi të fuqizojmë shpirtin tonë luftarak sindikalist. Dhe të tregojmë që sindikatat janë një forcë, e cila i kultivon marrëdhëniet në vend.

➔ Aurora García

Intervistë



Anja Peter, sekretare nacionale për barazi

Barazi në paga tani – jo gjëra të lëna përgjysmë!

Para pak kohësh qeveria federale ka dërguar për procedurë aprovimi revidimin e ligjit për barazi (gjinore). Mirëpo Unia nuk është fare e kënaqur me propozimin e qeverisë federale. Anja Peter, sekretare nacionale na tregon përse.

Anja, gratë e Unia-s me 2 mars 2016 kanë zhvilluar një aktivitet në sheshin e federatës, në të cilin kanë kërkuar «jo gjëra të lëna përgjysmë». Kush është duke bërë këtu gjëra përgjysmë?

Ne me 2 mars kemi dorëzuar qëndrimin tonë përkitazi me revidimin e ligjit për barazi (gjinore). Nga këndvështrimi ynë qeveria federale është duke bërë pak sa i përket çështjes së barazisë në paga. Në qëndrimin tonë ne kemi theksuar se: qeveria federale ndanë gjithashtu mendimin se ligji është i pamjaftueshëm, megjithatë e merr fare pak parasysh këtë fakt për revidim. Çka mungon sipas pikëpamjes tëndë në propozim-ligjin e qeverisë federale?

Është fjala për tri rrafshë. E para ka të bëjë me kontrollet e propozuara të pagave nëpër firma: Propozimi i ligjit parasheh që ndërmarrjet duhet të kontrollojnë pagat çdo katër vjet dhe se kjo duhet bërë nga subjekte të jashtme. Mirëpo ligji nuk kërkon që rezultat e kontrolleve të publikohen. Kështu mungon transparenca. Gratë nëpër ndërmarrje nuk e dinë se a kanë të prekura dhe se a duhet që pagat e tyre të përshtaten.

Kjo i bie se barra për ti realizuar të drejtat e tyre, bie mbi gratë?

Saktësisht, dhe kjo na qon tek rrafshi i dytë. Zbatimi i barazisë në paga mbetet çështje e grave, e secilës veç e veç. Ato duhet të shohin vet, se a është korrekte paga që ato marrin. Pastaj ato duhet të vet të bëjnë padinë, nëse vendosin për këtë. Ndërsa një padi është, ashtu sikur e dimë nga përvojat e ndryshme, një proces i gjatë, i shtrenjtë dhe i rënduar.

Gratë sindikaliste kanë përsëritur disa herë kërkesën për «zyrtarët për kontrollin e pagave». A parashihet kjo edhe për këtë rast?

Jo, kjo është paraparë paraprakisht, por pastaj është hequr teksti përkatës nga ligji. Ideja ishte që zyra federale për barazi (gjinore) posedon pikërisht këto kompetenca: Disponon me resurse dhe mjete për të realizuar kontrollet, për të ndërmarrë vendimet sanksionuese dhe për të ndikuar si paditëse. Mirëpo qeveria federale ka vendosur kundër dhe kështu «gjërat janë mbetur përgjysmë».

Gati një javë më vonë ishte dita ndërkombëtare e grave. Edhe këtu Unia ishte prezent, porse në qendër të vëmendjes ishte iniciativa AHV/AVS-plus. A ka ndonjë ndërlidhje mes AHV/AVS dhe barazisë në paga?

Njëra ndikon tjetrën. Ose thënë ndryshe: Kush fton më pak, më vonë merr gjithashtu një pension më të ultë. Grat janë të prekura shumë, pasi shpesh kryejnë punë, të cilat paguhen pak. Pos kësaj ato kryejnë shumë punë, për të cilat nuk paguhen fare. Në pleqëri ato marrin vetëm një pension pleqërie të AHV/AVS-it dhe gati se asnjë shtesë nga arka e pensionit profesional. Vetëm 20% e burrave nuk marrin pension nga sigurim profesional, ndërsa përqindja tek gratë është 48%. Ko tregon se pensionet shoqërore të pleqërisë AHV/AVS për gratë janë shumë të rëndësishme, andaj ato urgjentisht duhet të rriten.

Iniciativa AHV/AVS-plus është gjithashtu mjete më mirë kundër planeve reduktuese të Parlamentit. Ne duhet të forcojmë AHV/AVS-in! Ajo është përkujdesja jonë korrekte dhe solidare e pleqërisë – secilin frang që ne e paguajmë dhe për të cilin ne në fund marrim më pak. Andaj gratë e Unia-s angazhohen fuqishëm për iniciativën AHV/AVS-plus!

➔ Aurora García

Broshura mbi diskriminimin në paga

Unia ka përpiluar një broshurë, e cila ndihmon se si mund të mbrohen gratë nga diskriminimi në paga dhe se kua ato në rast nevojë mund të gjejnë mbështetje.

Broshura është publikuar në 8 gjuhë: gjermane, italiane, frënge, portugeze, shqipe, spanjolle, serbo-kroate-boshnjake dhe turke.

Edhe Kanton Vaud (Waadt) me grup të sindikalistëve shqiptar

Shtohet pjesëmarrja aktive në jetë sindikaliste



Ekrem Shaqiri, i dyti na e majta, iniciatori grupit të sindikalistëve shqiptar

Në Lozanë (Kanton VD) të Zvicrës, të premten, më 11 mars 2016 në lokalet e sindikatës Unia u zhvillua një tubimin ku morën pjesë mbi 20 anëtarë aktiv të Sindikatës Unia nga radhët e komunitetit shqiptar. Si pikë e parë e rendit të punës ishte krijimi i grupit shqiptar. Më pas u trajtuan edhe tema që preokupojnë komunitetin tonë në Zvicër, si Marrëveshja e munguar ndërshtetërore për Sigurimet Shoqërore me Kosovën dhe aktualiteti politik në Zvicër në raport me të drejtat e migrantëve dhe njerëzve me sfond migracioni si dhe pjesëmarrja e shqiptarëve në jetën politike e shoqërore.

Grupi organizues me iniciativën e punëtorit të ndërtimtarisë, aktivistit shumëvjeçar sindikalist të këtij regjioni, Ekrem Shaqiri i mbështetur edhe nga sekretari regional sindikal Arben Krasniqi pas takimit parapërgatitor të mbajtur para disa muajsh në Rennes, kësaj radhe arritën të motivojnë dhe mobilizojnë një numër të konsiderueshëm të anëtarëve kryesisht aktiv të sindikatës Unia për të jetësuar nismën e marrë përsipër në seminarin e fundit nacional në gjuhën shqipe për krijimin e grupeve të sindikalistëve shqiptar nëpër të gjitha regjionet mundshme të Zvicrës. Ekremi dhe sekretari Arben Krasniqi kishin ftuar edhe aktivistë politik, kulturor e shoqërore nga radhët e komunitetit tonë në regjion, ku do të veçojmë politikanin Musa Kamenica, shqiptaro-zvicerani e parë të zgjedhur deputet në Parlamentin e qytetit të Lozanës. Ai përshëndeti iniciativën dhe ndër të tjera u zotua se do të angazhohet në mbështetje të gjitha nevojave dhe kërkesave të mundshme të komunitetit tonë në Lozanë, regjion dhe më gjerë. Pjesëmarrësit e manifestimit gjatë tërë tubimit ishin mjaft aktiv në bashkëbisedim. Një pjesë e tyre edhe pse punojnë e jetojnë me vite të tëra në Zvicër, ata nuk kanë të rregulluar qëndrimin e tyre në Zvicër. Ky grup bashkë me ta do të angazhohet edhe për legalizimin e qëndrimit të tyre të rregullt në Zvicër. Për marrë parasysh edhe preokupimet personale të të gjithë të pranishmëve, fillimisht u zgjodh edhe trupi koordinues i grupit të shqiptarëve dhe u caktua takimi i radhës për muajin prill 2016.

Angazhim i vazhdueshëm edhe për migrantët

Në këto mbi dhjetë vite UNIA është angazhuar fuqishëm në shumë lëmi: qoftë për pensionimin e mëhershëm në sektorin e ndërtimtarisë dhe tregtisë, qoftë kundër orarit të zgjatur të punës nëpër shitore, apo edhe kun-

dër dumpingut në paga dhe vjedhjes së pensioneëve. Unia është angazhuar në vazhdimësi edhe për migrantët. Qoftë për të drejtat nga rrafshi i sigurimeve shoqërore apo edhe kundër iniciativave të panumërta ksenofobe, sikur ajo për dëbim ose atë mbi migrimit masiv, të cilat gjithashtu u trajtuan mjaftueshëm në këtë takim. Edhe në të ardhmen ky angazhim do të vijojë të fuqizohet edhe më shumë, falë edhe angazhimit aktiv të anëtarësisë së saj!

Sindikata Unia dhe shqiptarët e Zvicrës

Nga angazhimi i sindikatës Unia në rrafshin kombëtar dhe ndërkombëtar, pra kanë përfituar edhe shqiptarët. Këtu përpos përfitimeve të përgjithshme nga Kontratat Kolektive të Punës, të drejtat dhe mbrojtjen në punë, do të veçonim angazhimin e Unia-s për qarkullimin e lirë edhe të migrantëve shqiptarë të punësuar në Zvicër në hapësirën Shenjen e veçanërisht angazhimin e gjithanshëm të saj dhe partnerëve tjerë për Marrëveshjen e anuluar ndërshtetërore mbi Sigurimet Shoqërore mes Zvicrës e Kosovës, me ç'rast shumë punëmarrës nga Kosova, si kontribuuesit kryesorë në të dy vendet dhe shoqëritë, ka 6 vite që vazhdojnë të përjetojnë diskriminim selektiv nga fusha e sigurimeve shoqërore, për shkak të mosmarrëveshjeve dhe mungesës së vullnetit të mirë në mes të zyrtarëve të dy vendeve. Në sindikatën Unia, nga gjithsej 200000 anëtarë, së paku mbi 100000 janë me prejardhje nga jashtë Zvicrës, nga të cilët rreth 15000 janë shqiptarë. Për të komunikuar më mirë, për të mobilizuar dhe organizuar edhe punëmarrësit me prejardhje shqiptare në sindikatën Unia, përpos aktivistëve sindikalistë shqiptar, sindikata Unia ka punësuar një numër të konsiderueshëm i shqiptarëve në stafin profesional të saj. Unia publikon edhe fletëpalosje, broshura e



Arben Krasniqi, sekretar sindikal



Musa Kamenica, deputeti i Lozanës

materiale të ndryshme informuese nga sektorë të ndryshëm të botës së punës dhe jetës shoqërore në Zvicër si dhe nxjerrë pos tjerash edhe shtojcën e gazetës sindikaliste «Horizonte» edhe në gjuhën shqipe.

Organizimi në grupe interesi deri edhe në grupe gjuhësore

Sindikata Unia me statute mundëson pjesëmarrjen e të gjithë anëtarëve pa marrë parasysh sfondin e tyre dhe pa marr parasysh se a kanë apo jo pasaportë zvicerane. Kështu Unia si organizata më e madhe që organizon migrantët posedon edhe me organe e struktura të migracionit, vendimet e të cilave janë të detyrueshme për të gjithë organizatën. Përpos grupeve të interesit në nivele regjionale, ekzistojnë edhe komisioni nacional i migracionit, i cili mbledhet 2-3 herë në vit si dhe konferenca nacionale e migracionit, e cila është organi më i lartë i migracionit në sindikatën Unia dhe e cila propozon e aprovon kërkesa e vendime, apo dominon, delegon e zgjedh përfaqësues e delegatë në organet e strukturat tjera të sindikatës dhe në drejtoritë nëpër seksione e regjione. Përpos grupeve regjionale të migracionit, komisionit dhe konferencës së migracionit, që janë organe e struktura të sindikatës, anëtarët kanë të drejtë të organizohen edhe në grupet e tyre gjuhësore, të cilat nuk janë organe e struktura, por të cilat kanë të drejtë dhe mund të delegojnë anëtarët në të gjithë sektorët ekonomik, në grupet e interesit dhe në organet e strukturat të sindikatës së tyre. Këtë qëllim ka edhe krijimi i grupit shqiptar të Unia-s të Lozanës. Edhe përkundër rezultateve të arritura, sindikata Unia zotohet se do të angazhohet edhe më tej fuqishëm për të avancuar të drejtat e të gjithë punëmarrësve dhe për t'u bërë ballë sulmeve për dobësimin e sindikatave dhe lëvizjeve punëtoje gjithandëj si dhe sulmeve karshi të arriturave të deritashme në botën e punës në Zvicër dhe më gjerë. Dhe edhe në të ardhmen nën moton: Bashkë jemi më të fortë!

Osman Osmani Sekretar nacional për migracion në Unia



Pamje nga tubimi themelues i grupit sindikalist shqiptar

Ju pyesni, Unia përgjigjet



Pensioni për personat e vejë: A guxon AHV/AVS ta anulojë atë?

Imam 25 godina i radim u jednom restoranu kao konobarica. Od po etka godine odbijaju mi se mnogo ve i doprinosi na ime penzion kase nego ranije. Moja šefica mi je objasnila da je ovo pove anje povezano sa godinama starosti. Od 25. Godine starosti doprinosi za penziona osiguranje se znatno pove avaju. Da li je to ta no?

Po. Një person i vejë merr pensionin për të vejë deri kur fëmija më i vogël mbush moshën 18 vjeç. Kështu qëndron në Nenin 24 të ligjit për pensionin publik të pleqërisë dhe trashëgimtarëve (AHV/AVS). Se a ndjekë vajza juaj ende shkollimin profesional, kjo nuk luan ndonjë rol. Pensionin tuaj të fundit e merrni në muajin e fundit, në të cilin vajza juaj mbush të 18-at. Nëse një person i vejë nuk ka fëmijë, kështu ai nuk merr fare pension për personat e vejë nga AHV/AVS. Legjislacioni i ka anashkaluar me vetëdije vejanët në raport me vejushat. Një grua e martuar, e cila ka fëmijë dhe të cilës i ka vdekur bashkëshorti, gjithmonë ka të drejtë në pension të vejushave. Moshë e fëmijëve nuk luan ndonjë rol. Në raste të caktuara vejusha edhe në rast se nuk ka fëmijë, guxon të drejtën e pensionit për vejushat. Gjithmonë kur ajo me rastin e vdekjes së burrit është në moshën 45 vjeç e më shumë dhe në rast kur bashkëshortësia (martesa) ka zgjatur së paku pesë (5) vite.

Peter Schmid, work, 4.2.2016

Pensioni i pleqërisë AHV/AVS: A përllogariten edhe kontributet nga Gjermania?

Unë jam rritur në Gjermani, ku kam kryer edhe shkollimin profesional dhe ku kam punuar disa vjet në profesionin e mësuar. Ka shumë vite që jetoj dhe punoj në Zvicër dhe sivjet do të dal në pension. A do të më llogariten për të përfituar edhe vitet e kontributeve në arkat e sigurimeve shoqërore të Gjermanisë me rastin e marrjes së pensionit zviceran të AHV/AVS-it?

Mjerisht jo. Ju krahas pensionit të AHV/AVS do të merrni si shtesë një pension të pjesshëm nga Gjermania. Një person, i cili ka punuar në shumë shtete, në moshën e pensionit apo në rast të invaliditetit merr nga një pjesë të pensionit nga shtetet në të cilat ka punuar. E njëjta vlen edhe për trashëgimtarët me rastin e vdekjes së personit të siguruar. Lartësia e pensionit përllogaritet për periudhën kohore, për të cilën janë paguar kontributet në secilin shtet. Pra, nuk ka fare rëndësi në cilin shtet del në pension personi në fjalë. Pensioni do të duhej paguar në shtetin ku banon (me të cilin zbatohen Marrëveshjet ndërshtetërore për Sigurimet Shoqërore). Të drejtë pensioni ka secili që për së paku 1 vit ka paguar kontribute në arkat e sigurimeve shoqërore. Më tutje duhet plotësuar edhe parakushtet tjera për të pasur drejtë në pension. Kjo varet nga shteti në shtet.

Philip Thomas, work, 3.11.2011

Impressum: **Bellage zu den Gewerkschaftszeitungen** work, area, Événement syndical | **Herausgeber** work, Gewerkschaft Unia, Chefredaktion: Marie-José Kuhn; Événement syndical SA, Lausanne, Chefredaktion: Sylviane Herranz; Edizioni Sociali SA, Lugano, Chefredaktion: Claudio Carrer | **Redaktionskommission** A. García, A. Rogalewski, D. Filipovic, E. Sariasslan, M. Martin, M. Mendes, O. Osmani | **Sprachverantwortlich** Osman Osmani | **Layout** C. Lonati, Unia | **Druck** Tagblatt Print, Im Feld 6, 9015 St. Gallen | **Adresse** Unia Redaktion «Horizonte», Weltpoststrasse 20, 3000 Bern 15, osman.osmani@unia.ch



Die Gewerkschaft. Le Syndicat. Il Sindacato.

www.unia.ch